



Smaltofill

Stuko e lehtë

Stuko akriliku me peshë të lehtë



Shkalla e përhapjes: Në varësi të trashësisë së shtresës



Tharja: 1 - 8 orë



Hollimi: -



Mundësia për shtresë të dytë: 1 shtresë



Paketimi: 500ml, 1L

Aplikimi: Me spatul

KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME

Stuko e gatshme e bardhë me peshë të lehtë me bazë rrëshire akriliku të kopolimerit. Mund të përdoret për të mbushur nyje ose për të riparuar vrima deri në 5cm në sipërfaqe të brendshme muresh gipsi, suvaje, beton, tullë, dru, etj. Është e butë në përdorim, përhapet në mënyrë të njëtrajtshme, nuk rrëshqet dhe mbushet në mënyrë të përsosur. Nuk pëson deformime, thahet shpejt pa krijuar gunga dhe fërkohet lehtë duke dhënë një sipërfaqe të lëmuar dhe që zgjat, e cila mund të lyhet me çdo lloj ngjyre.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

Dendësia	0,6 ± 0,02 kg/l
Shkalla e përhapjes	Në varësi të trashësisë së shtresës.
Hollimi	Gati për përdorim.
Tharja	1-8 orë, në varësi të trashësisë së shtresës dhe kushteve të motit.
Mundësia për shtresë të dytë	1 shtresë
Klasa e POA	“Astarë izolues”. Tipi WB. Limiti VOC = 30gr/lt. VOC maksimal i produktit, i gatshëm për përdorim = 5gr/lt.
Ngjyra	E bardhë.



PËRGATITJA E SIPËRFAQES

Pastroni plotësisht sipërfaqen nga vajrat, pluhuri, papastërtitë e huaja, copëzat e lira, lagështia, etj.

APLIKIMI

Është gati për përdorim. Nuk aplikohet në temperatura nën 5°C dhe mbi 30°C. Aplikoni stukon e lehtë në mënyrë të njëtrajtshme me spatul. Pasi të thahet mirë, pastrojini me rërë dhe më pas lyeni fillimisht me Smaltoplast Universal Primer ose me astar SMALTODUR hydro, SMALTODUR, SMALTOX hydro, SMALTOX mono, MASTER PRIMER ose me astarin VELATOURA SMALTOLUX në varësi të përdorimit përfundimtar.

MJETET E PASTRIMIT

Mbajini mjetet e njoma dhe shkundini mirë nga boja kur ti vendosni në kovë. Pastrojini menjëherë me ujë dhe sapun.

KUSHTET E APLIKIMIT

Temperatura e dhomës 8-30°C dhe niveli relativ i lagështirës më i ulët se 80%. Kushtet e këqija gjatë aplikimit mund të ndryshojnë vetitë e produktit në fund.

RUAJTJA

Pas aplikimit, mbyllni enën fort për ta ruajtur në gjendje të mirë për përdorim në të ardhmen. Ruajini në një ambient të freskët. Mbroni materialet nga ngrirja dhe ekspozimi në diell.

SIGURIA

Lexoni etiketën përpara përdorimit. Për udhëzime më të hollësishme - masa parandaluese, konsultohuni me fletën e të dhënave të sigurisë së produktit.



Të dhënat dhe udhëzimet teknike të përfshira në këtë fletëpalosje teknike bazohen në kontrollet e laboratorëve konfidencial dhe janë rezultat i njohurive dhe përvojës së stafit shkencor të shoqërisë. Cilësia e produktit garantohet nga shoqëria, i cili është në përputhje me kërkesat e ISO 9001, 14001 dhe EMAS. Si prodhues, ne nuk mbajmë përgjegjësi për asnjë dëm apo dëme të shkaktuara nëse produkti nuk është aplikuar për përdorimin e duhur dhe në përputhje me udhëzimet për përdorimin.